



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2021:139607

Datë: 11.12.2024

Numri i dokumentit: 06348647

CN.nr. 36/21

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH – Departamenti i përgjithshme, Divizioni civil, nga gjyqtarja Sabaheta Kurteshi me bashkëpunëtorin profesional Gjelbrim Gërdellaj, në lëndën jokontestimore të propozuesit P. D. nga fshati..., Komuna e Dragashiti, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit av. A. R. nga Dragashi, kundër kundërpropozuesve: S. D. nga fshati..., Komuna e Dragashit, Xh. P. e lindjes D. nga fshati..., Komuna e Dragashit, të dy të përfaqësuar sipas autorizimit nga av. A. A. nga Prizreni dhe N. Rr. e lindjes D. nga fshati..., Komuna e Dragashit, e përfaqësuar nga përfaqësuesi i përkohshëm av. M. S. nga Dragashi, lidhur me propozimin për ndarje fizike të pasurisë, duke vendosur sipas propozimit për ndërprerje të procedurës të autorizuarit të kundërpropozuesve S. D., Xh. P. dhe Nadira R. respektivisht avokatet A. A. nga Prizreni dhe M. S. nga Dragashi, më dt. 11.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Procedura në këtë çështje jokontestimore **NDËRPRITET** për shkak të zgjidhjes së çështjes paraprake.

II. UDHËZOHEN kundërpropozuesit S. D., Xh. P. dhe N. R. e lindjes D. – të autorizuarit e tyre av. A. A. dhe av. M. S., që të inicojnë procesin kontestimor në afatin ligjorë prej 15 ditë dhe njëherit edhe të njoftojnë gjykatën për veprimin e ndërmarrë.

III. Në qoftë se të larëpërmendurit nuk veprojnë sipas këtij udhëzimi, procedura e ndërprerë do të vazhdohet dhe përfundoj pa u marrë parasysh kërkesa lidhur me udhëzimin për iniciimin e procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Pranë kësaj gjykate me dt. 30.06.2021 është inicuar propozim për ndarjen fizike të pasurisë nga propozuesi P. D. nga fshati..., Komuna e Dragashit, kundër kundërpropozuesve S. D. nga fshati..., Komuna e Dragashit, Xh. D. – P. nga fshati..., Komuna e Dragashit dhe N. R. e lindjes D., nga fshati..., Komuna e Dragashit.

Në sencën e datës 25.10.2024, i autorizuari i propozuesit av. A. R. ka deklaruar se qëndron pranë propozimit duke arsyetuar se: “Gjatë shqyrtimit janë shterrur të gjitha dilemat e mundshme andaj i propozojmë gjykatës që sa më parë të vendosi lidhur me këtë çështje, duke patur parasysh edhe

kohën e paraqitjes së propozimit si dhe natyrës së shqyrtimit, deklaratimet e palëve konsiderojmë se janë konsumuar të gjitha pretendimet dhe tani më është fare e qartë se cilat nga këto janë të bazuara e cilat jo. Sa i përket propozimit të kundërpropozuesve për ndërprerje të procedurës, konsiderojmë se nuk ka asnjë arsye të paraparë me nenin 200 që kjo procedurë të ndërpritet, andaj kërkujmë nga i autorizuari i kundërpropozuesit që të deklarohet se cilat rrethana është kontestuese madhësia e sendeve apo pjesëve të përbashkëta, sepse sipas dispozitave të nenit 200 jo në secilin rast të ndarjës fizike duhet të jepet mundësia për padi”.

I autorizuari i kundërpropozuesve S. D. dhe Xh. P. – av. A. A. nga Prizreni ka deklaruar: “Në tërësi qëndrojmë pranë kundërshtimeve të theksuara si në seancat paraprake lidhur me këtë çështje jo kontestimore, duke marr parasysh se këtu palët kundër propozuese nuk pajtohen me propozimet për ndarjen fizike të ngastrave, në cilësi të të autorizuarit të tyre, duke marr parasysh se këtu është kontestuese pozita dhe sipërfaqja e ngastrave të cilat shfrytëzohen aktualisht nga palët, andaj në këto rrethana i propozoj gjykatës që këtë procedurë jo kontestimore ta ndërpres konform nenit 200 të LPJK-së, dhe lidhur me pretendimet dhe të drejtat e këtu kundërpropozuesve do të realizojmë në procedurë kontestimore brenda afateve ligjore. Kontestuese për kundërpropozuesit është vetëm pozita e shfrytëzimit aktual të ngastrave lëndore për faktin se pjesa ku e shfrytëzon përkatësisht oborrin kundër propozuesi, këtë pjesë ai e shfrytëzon mbi 40 vite, duke mos u penguar nga askush dhe se një ndarje e propozuar nga eksperti i gjeodezisë duke ia marr këtë pjesë përkatësisht ti takon propozuesit është e pa pranueshme për të dhe këtë fakt dhe këtë të drejtë i njëjti do ta realizojë në procedurën kontestimore”.

I autorizuari i kundërpropozuesit S. D. – av. A. A. nga Prizreni ka deklaruar: “Në tërësi e mbështes propozimin e kolegut tim Av. A. A., që të ndërprehet procedura në këtë çështje jo kontestimore”.

Gjykata vendosi pas shqyrtimit të këtij propozimi si dhe shkresave që gjenden në dosjen e lëndës e në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore (tutje: LPJK), konkretisht në nenin 200 par. 1 të tij është percaktuar, citojmë: *“Në qoftë se gjykata, duke vepruar sipas propozimit të një bashkëpronari, konstaton se ndërmjet bashkëpronarëve kontestuese është e drejta mbi sendet që janë objekt ndarjeje ose madhësia e pjesëve në sendet e përbashkëta, përkatësisht në pasurinë që është e përbashkët, ose kur konstaton se është kontestuese rrethana se cilat sende, respektivisht cilat të drejta bëjnë pjesë në pasurinë e përbashkët, atëherë ajo e ndërpret procedurën dhe e udhëzon propozuesin që brenda afatit 15 ditësh me padi ta inicojë procedurën kontestimore.”.*

Andaj gjykata në kuptim të fakteve si dhe provave të administruara si në shkresat e lëndës e gjithashtu edhe bazës juridike të cituar, padyshim vërteton konstatimin e gjykatës si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Kjo pasi që ndërmjet propozuesit dhe kundërpropozuesve ekzistojnë fakte kontestuese që në këtë procedurë nuk mund të procedohen dhe veqanërisht pretendimeve të ngritura nga i autorizuari i propozuesve avokati A. A. nga Prizreni dhe M. S. nga Dragashi, ku janë prezentuar mjaftë çështje të cilat kjo gjykatë në këtë procedurë nuk mund t’i shqyrtoj, sepse paraqet procedurë veçantë e rregulluar me ligj të veçantë. Kjo para së gjithash duke marrë për bazë faktin se propozuesi dhe kundërpropozuesit kanë mosmarrëveshje në lidhje me pozitën dhe sipërfaqën e ngastrave (madhësinë e tyre) të cilat shfrytëzohen faktikisht nga palët e këtë e argumenton edhe më tepër fakti se palët edhe në raportin e ekspertit të gjeodezisë në lidhje me propozimin për ndarje fizike, kanë shprehur qëndrime diametralisht të kundërta duke shprehur mosmarrëveshje dhe mos pajtime në lidhje me këto propozime për ndarje fizike të

patundshmërisë e të cilat janë të përshkruara detajisht edhe në ekspertizën gjeodezike të dt.03.02.2024 (fakte këto që janë të evidentuara gjithashtu edhe në procesverbalin e seancës të dt. 03.09.2024).

Andaj kjo gjykatë në kuptim të dispozitave të nenit 200 par. 1 dhe 2 të Ligjit për procedurën Jokontestimore lidhur me nenin 22 dhe 23 të tij, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Ndërkaq udhëzimin lidhur me afatin për iniciimin e procedurës kontestimore si dhe njoftimit të gjykatës në lidhje me këtë veprim, gjykata e mori në kuptim të nenit 200 par. 1 dhe 2 të LPJK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHME - DIVIZIONI CIVIL
2021:139607, 11.12.2024**

Gj y q t a r j a,

Sabaheta Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi trashëgimtarët kanë të drejtë Ankesë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 dite nga dita e pranimet të këtij Aktvendimi, përmes kësaj gjykate.